



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1391/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a me seli në Prishtinë, kundër debitorit Lokal N.R. me nr. personal ..., me adresë në Ferizaj, rr. "...” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1446/2018 të datës 20.12.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës me datë 31.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Lokal N.R. me seli në Ferizaj ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr. 1446/2018 të datës 20.12.2018, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Mubarak S. Shumolli.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 20.12.2018 ka lëshuar urdhër përmbarimor P.nr. 1446/2018, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit Ekstrakt nga librat afarist DFE ... të datës 18.12.2018, duke urdhëruar debitorin Lokal N.R., që në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike, t’ia paguaj kreditorit borxhin e përcaktuar sipas dokumentit të lartcekur në shumën prej 524.71 EUR (pesëqind e njëzet e katër euro e shtatëdhjetë e një euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se i njëjti nuk është fare debitor në këtë procedurë dhe se me kreditorin ka nënshkruar kontratën për pagesën e kësteve mujore sipas urdhrit të Qeverisë për faljen e borxheve dhe se borxhi për periudhën 24.10.2002 deri më 19.12.2008 veç se është falur, ndërsa borxhi për periudhën 18.03.2006 e deri më 20.03.2013 është parashkruar pasi që propozimi

për përmbarrim është paraqitur në datën 20.12.2018. Me kërkesë që të aprovet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarrimit.

Kreditori në përgjigjen ndaj prapësimi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura duke shtuar se nga ekstrakti i librave afarist, tek kriteri minimal është precizuar borxhi komulativ dhe jo i ndarë nga fatura në faturë, ndërsa pagesat reciproke të pa definuara kanë mbuluar borxhin deri në datat e propozimit të bërë. Tutje ka shtuar se debitori ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit me datë 31.08.2016 dhe deklaratë mbi dakordimin e borxhit me datë 27.01.2017, por për shkak të mos pagesës së një (1) kësti, vlera e falur e borxhit i është rikthyer, ndërsa pagesat e bëra në emër të borxhit janë zbritur nga vlera e përgjithshme. Ka shtuar se nga kontrata dhe deklarata mbi pranimin e borxhit, debitori ka pohuar në tërësi borxhin andaj në këtë rast kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit dhe rifillim të afatit të saj. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarrimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Ferizaj, lidhur me këtë çështje përmbarrimore, me Aktvendimin PPP.nr. 235.19 të datës 14.02.2020 ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor P.nr. 1446/2018 të datës 20.12.2018 dhe lëndën e ka kthyer në ri procedim pranë Përmbarruesit Privat me arsyetimin se propozimi për përmbarrim, nuk përmban të dhënat e mjaftueshme lidhur me debitorin pasi që nuk është shënuar numri i biznesit të debitorit, andaj edhe nuk dihet se a kemi të bëjmë me person fizik apo person juridik.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, me Aktvendimin Ac.nr. 3130/2017 të datës 19.08.2021, ka aprovuar si të themeltë ankesën dhe ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 132/2016 të datës 22.02.2017 të Gjykata Themelore në Ferizaj, duke kthyer lëndën në procedim të serishëm. Në arsyetimin e saj ka shtuar se në propozimin për përmbarrim, janë shënuar emri dhe mbiemri i debitorit, adresa, numri personal, numri i konsumatorit, grupi tarifor dhe se debitori është regjistruar pranë kreditorit si biznes, andaj propozimi për përmbarrim është hartuar konform neni 38 të LPP-së. Me kërkesë që në rivendosje të vlerësohet edhe njëherë a është plotësuar njëri nga kushtet e prapësimi sipas nenit 71 të LPP-së.

Gjykata, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr. 3130/2017 të datës 19.08.2021, në kuptim të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139

për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 38 të këtij ligji përcaktohet se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se *“ Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*.

Nga të lartcekurat, Gjykata fillimisht konstatoj që si debitor në propozimin për përmbartim është evidentuar Lokal N.R. me nr. personal ..., të dhëna këto që evidentohen edhe në ekstraktin mbi librat afarist DFE ... të datës 18.12.2018 mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Nga këtë drejtim, Gjykata gjeti se Përmbartuesi Privat, pas lëshimit të urdhrin për lejimin e përmbartimit, përmes komunikimit elektronik të datës 22.02.2019, ka kërkuar nga kreditori që ta verifikoj numrin personal ... të evidentuar tek debitori, pasi që i njëjti nuk përputhet me të dhënat e debitorit N.R.. Ndërsa, nga përgjigja në këtë kërkesë e drejtuar nga kreditori po ashtu përmes komunikimit elektronik të datës 03.04.2019, Përmbartuesi Privat është informuar se propozimi për përmbartim është iniciuar ndaj N.R., kurse numri personal ... i evidentuar në propozimin për përmbartim dhe në ekstraktin nga librat afarist i përket personit Bekim Sadiku, andaj është kërkuar nga Përmbartuesi Privat që pas verifikimit të dërgoj shkresë për saktësimin e propozimit veç e veç me qëllim të vazhdohet procedura.

Përkundër kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se procedura përmbartimore është vazhduar përsëri ndaj N.R., përkundër që numri personal i shënuar në propozimin për përmbartim ka të bëjë me një person të tretë. Rrjedhimisht, duke iu referuar nenit 43 të LPP-së përcaktohet se *“Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e*

procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”, Gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e Urdhrit Përmbarrimor nga ana e Përmbarruesit Privat, pasi që dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, nuk i përmban elementet nga neni 38, par.2 i LPP-së, sepse numri personal i evidentuar në propozimin për përmbarrim dhe në ekstraktin nga librat afarist nuk i përket debitorit N.R., ndërsa kjo e metë nuk është evituar në fazën para lejimit të përmbarrimit, qoftë duke u evidentuar numri i saktë personal i debitorit N.R., apo duke u zëvendësuar emri i debitorit me emrin e personit i cili mban numrin personal

Mbi këtë bazë, Gjykata gjen se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përmbarrimin ndaj debitorit Lokal N.R., përderisa në propozimin për përmbarrim, numri personal identifikues i referohet një personi krejtësisht tjetër, andaj në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par. 1.6 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarrimin kundër debitorit”* Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit.

Me rastin e vendosjes, Gjykata pati parasysh qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhënë me Aktvendimin Ac.nr. 3130/2017 të datës 19.08.2021 se propozimi për përmbarrim përmban të gjitha të dhënat siç kërkohen me nenin 38, par.2 të LPP-së, por që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga vet deklarimi i palës kreditore në komunikimin elektronik të datës 03.04.2018, rezulton se numri personal identifikues i evidentuar në propozim, nuk ka të bëjë me debitorin Lokal N.R., e meqenëse evitimi i të metave lidhur me debitorin nuk është bërë në fazën para lejimit të përmbarrimit, ndërsa në këtë fazë të procedurës Gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së urdhrit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, në kuptim të nenit 43 dhe nenit 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1391/22, datë 31.07.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.